



Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Fakulteti i Shëndetit Publik
Departamenti i Infermierisë

Kënaqësia në punë e infermierëve të repartit të pediatri në spitalet Fier dhe Vlorë

TEMË PËR CIKLIN E DYTE TË STUDIMEVE

Punoi: Mirela Hoxha Metohu

Udhëheqës shkencor: PhD Fejzi Alushi

Vlorë, 2019

Abstract:

Hyrje: Kënaqësia e punës së infermierëve është një aspekt shumë i rëndësishëm dhe një pikë shqetësimi për cdo organizatë shëndetsore. Infermierët kanë vendet më të shumta të punës në këto institucione, dhe zëvendësimi i personelit është i kushtueshëm dhe konsumon shumë kohë. Në punën spitalore shumë kolegë infermierë janë të ekspozuar ndaj niveleve të ndryshme të kënaqësisë në punë, por çfarë i bën infermierët të jenë të kënaqur ose jo me profesionin e tyre, të cilin mund ta kenë zgjedhur edhe vetë?

Qëllimi i kësaj teme ishte vlerësimi i kënaqësisë në punë i infermierëve të reparteve të pediatriisë Fier dhe Vlorë me qëllim gjetjen e faktorëve që ndikon në kënaqësinë në punë.

Metoda dhe materialet: Në këtë studim morën pjesë 50 infermierë nga repartet e pediatriisë të spitalit të Vlorës dhe të Fierit të cilët plotësuan një pyetësor me 49 pyetje për të parë nëse ata ishin të kënaqur me punën e tyre dhe nëse kishte faktorë që ndikonin në këtë kënaqësi. Analiza e të dhënave u realizua përmes paketës statistikore SPSS version 22.

Rezultatet: 30% e infermierëve të pyetur ndihen të pakënaqur nga puna e tyre kurse 42% e infermierëve janë shprehur se janë të kënaqur nga puna e tyre. Pjesa më e madhe e infermierëve 48% janë dakord dhe tregojnë një përkushtim organizativ të lartë. 80% e infermierëve pohojnë se identifikohen me profesionin e infermierit. 68% e infermierëve raportojnë shumë shpesh konfliktualitet në realizimin e detyrave. 68% e infermierëve të cilët kanë statusin e të martuarit janë grupi me nivelin më të lartë të kënaqësisë dhe përkushtimit në punë. 4% e infermierëve të divorcuar përjetojnë nivelin më të ulët të kënaqësisë dhe përkushtimit në punë. 8% e infermierëve të cilët kanë 15 – 24 vjet eksperiencë në punë janë më pak të kënaqur dhe të përkushtuar në punë.

Konkluzione: Në përgjithësi infermierët në spitalin rajonal të Vlorës dhe të Fierit në repartet e pediatriisë nuk janë të kënaqur. Gjendja civile dhe eksperiencia në punë ndikon në nivelin e kënaqësisë në punë. Përkushtimi organizativ është i lidhur me nivelin e kënaqësisë në punë.

Rekomandime: të rregullohen kushtet e punës, të promovohen infermierët, të rritet rroga, të kryhen studime të tjera në këtë fushë.

Fjalët kyçe: kënaqësi në punë, konfliktualitet, faktorë të kënaqësisë.

Permbajtja

Hyrje	4
Kapitulli II: Kënaqësia e infermierëve në punë dhe faktorët e lidhur me të	5
2.2 Elementët e kënaqësisë në punë.....	Error! Bookmark not defined.
Ka disa faktorë që ndikojnë në kënaqësinë në punë si stresi i rolit, dhe përkushtimi organizativ.....	5
2.3 Statistika të pakënaqësisë në punë	8
2.4 Mendimet infermiore mbështetja organizative dhe cilësia e kujdesit.....	12
2.5 Studime mbi kënaqësinë në punë të infermierëve	12
2.5.1 Lidshipi, vazhdimi i karrierës dhe edukimit, mungesa së stafit.....	12
2.5.2 Produktiviteti	14
2.5.3 Tejlodhja.....	14
2.5.4 Fuqizimi struktural	15
2.7 Infermiera dhe profesioni infermior në Shqipëri	17
Kapitulli III. METODOLOGJIA	19
3.1 Qëllimi i studimit:.....	19
3.2 Objektivat	20
3.3 Hipoteza	20
3.4 Tipi i studimit, popullata dhe zgjedhja e kampionit në studim.....	20
3.5 Mbledhja e të dhënave	20
3.6 Hartimi i Pyetësorit.....	20
3.7 Pyetësori përmbante komponentët e mëposhtëm:	21
3.8 Përkufizimi i ndryshorëve (variableve) të përfshirë në studim.....	21
3.9 Kodimi dhe Analiza e të dhënave	22
Kapitulli V: DISKUTIME	48
5.1 Kënaqësia në përgjithësi	48
5.4 Të dhënat demografike dhe kënaqësia në punë	50
✓ Arsimi:	50
✓ Gjendja civile.....	50
✓ Gjinia.....	50
✓ Eksperienca në punë	50
KAPITULLI VII: REFERENCAT	53
KAPITULLI VIII: SHTOJCA	58

Hyrje

Kënaqësia në punë është bërë një objekt shumë i rëndësishëm studim për kërkuesit. Punonjësit duan të trajtohen mirë në punë dhe me respekt. Kënaqësia në punë deri diku është reflektimi i një trajtimi të mirë. Kjo kënaqësi mund të konsiderohet si një tregues i mirëqënies emocionale. Menaxherët duhet të përqëndrohen në kënaqësinë në punë të punonjësve sepse punonjësit e pakënaqur kanë më shumë gjasa që të ofrojnë shërbime jo cilësore. Puna është mjeti kryesor i të ardhurave si dhe një komponent i rëndësishëm i jetës. Ajo zë një pjesë të madhe të ditës së një punonjësi dhe kontribon në nivelin social. Ka patur theksim të kosiderueshëm në menaxhimin e burimeve njerëzore në kohët e fundit. Në një organizatë produktiviteti dhe cilësia e shërbimeve varen totalisht në aftësinë e organizatës për të menaxhuar burimet njerëzore. Menaxhimi i burimeve njerëzore përfshin zhvillimin organizativ, zhvillimin e burimeve, dhe marrëdhëniet industrial. Burimet njerëzore funksionojnë në një organizatë duke përfshirë cdo gjë që ka të bëjë me njerëz, si rekrutim, inductim, mirëqënie, rritje, trajnim, zhvillim i aftësive, kompesim, motivim, dalje në pension etj.

Infermiera është përshkruar shpesh si një “gjigand që fle” e që duhet të zgjohet për të kuptuar potencialin e vet të plotë. Infermierët vazhdojnë të ofrojnë kujdes me elasticitet dhe shkathtësi, shpesh me pak apo pa burime apo mbështetje organizative. Infermiera është gjithashtu e përshkruar si shtylla kurrizore e ofrimit të kujdesit shëndetësor.

Reformat në modelin e kujdesit infermieror kanë patur një impakt në ofrimin e kujdesit shëndetsor. Kujdesi infermieror me qëndër pacientin ka zëvendësuar gradualisht modelin me qëndër sëmundjen. Këto ndryshime kanë koiciduar me një rritje të kuptimit të statusit profesional të infermierëve duke qënë se ka disa vite që në Shqipëri funksionon UISH dhe profesioni i infermierit është profesion i rregulluar me ligj, “provim lishencë kërkohet para se të punësohet një infermier”.

Edhe pse studiuesit kanë treguar disa nivele të kënaqësisë në punë për infermierët, predikuesit e kënaqësisë kanë tendencën të jenë shumë të ngjashëm, dhe përfshijnë kushtet e punës, marrëdhëniet me kolegët dhe drejtuesit, pagën, promocioni në punë, siguria për ta patur punën, përgjegjësia dhe turni. Në Shqipëri ka pak studime që kanë eksploruar kënaqësinë në punë dhe faktorët që kanë ndikuar në të.

Por përpos punës që infermieri shqiptar jep tek personat që kanë nevojë, sa të kënaqur janë vet infermierët me punën që bëjnë? Cilat mund të jenë arsyet e kënaqësisë apo pakënaqësisë në përditshmërinë e tyre gjatë punës? Po kur unë të filloj punën si infermiere, do të ketë faktorë që do të ndikojnë në punën time, në këtë profesion që e kam zgjedhur vetë dhe me caq dëshirë? Kjo është arsyeja pse unë për zgjedha këtë temë studimi për përfundimin e studimeve të masterit shkencor.

Kapitulli II: Kënaqësia e infermierëve në punë dhe faktorët e lidhur me të

2.1 Kënaqësia në punë

Schermerhorn e përkufizon kënaqësinë në punë si nivelin në të cilin individët ndjehen pozitivë ose negativë në punën e tyre. Është një përgjigje emocionale ndaj detyrës së dikujt si dhe gjendje fizike dhe sociale në vendin e punës. Kënaqësia në punë është motivuese dhe con në marrëdhëniet e mira në punësim dhe nivele të larta të performancës individuale në punë. Sipas Locke dhe Hanne, përkufizimi mund të jetë “gjendje e kënaqshme emocionale e cila vjen nga dikush kur ka kuptuar motivet e tij në punë”. Kënaqësia në punë është thjesht si njerëzit ndihen për punën dhe aspekte të ndryshme të saj. Ky është një variabël i sjelljes.

Sipas Wernerit kënaqësia në punë ka pesë aspekte që mund të përmbliidhen së bashku për të matur kënaqësinë në punë :

- ❖ Vetë puna- përgjegjësia, interesi dhe rritja
- ❖ Cilësia e mbikqyrjes-ndihma teknike dhe mbështetja sociale
- ❖ Marrëdhëniet me kolegët –harmonia sociale dhe respekti
- ❖ Mundësitë për promocion –shancet për avancim më tej
- ❖ Paga-saktësia e pagës dhe krahasimi më të tjerët

Ka disa faktorë që ndikojnë në kënaqësinë në punë si stresi i rolit, dhe përkushtimi organizativ.

Stresi i rolit në punë sugjeron se një rol është manifestimi i sjelljes së duhur ndaj pozicionit të një individi [4,5]. Në një organizatë, stresi i rolit të një individi I referohet “stresi i formuar nga pritshmëritë e kombinuara të sjelljeve të një individi nga të gjitha anët”. Ndërkohë që përjetohet stresi nga roli, një individ mund të paraqesë sjellje jo të përshtatshme në një institucion, si reduktim në performancën e punës, tejlohdje nga puna, dorëheqje, të cilat të gjitha kanë nevojë të merren seriozisht. Teoria e rolit [13] e ndan stresin nga roli në dy lloje; konflikti i rolit dhe dyshimin në rolin që ka individi [14] i cili ndahet më tej në tejkallim i rolit, pra janë tre lloje stresi [15,16].

Besohet se kënaqësia në punë është një sjellje pozitive ose negative që punonjësi ka ndaj punës së vet ose disa aspekteve specifike të punës, dhe është një gjendje e brendshme mendore e individit [17]. Kënaqësia është një ndjenjë apo tërheqje e një anëtari në një sistem pune; në qoftë se ndjenja është positive ose përgjigja është aktive, atëherë punonjësi është i kënaqur dhe e kundërta [18]. Ndjenjat e punonjësit drejtohen kundrejt punës, mbikqyrësit, grupit të punës, organizatës dhe jetës [19]. Niveli i kënaqësisë në punë varet nga ndryshimi midis asaj që personi aktualisht përfiton nga puna dhe çfarë ai/ajo pret [20,21]. Disa e kanë konsideruar kënaqësinë si një nivel në të cilin punonjësi e pëlqen ose jo punën e vet [22]. Gjithashtu është parë se kënaqësia është jo vetëm një

ndjenjë e individit për punën, por edhe një sjellje e përgjithshme mbi vlerësimin e përgjithshëm të të gjithë aspekteve të punës [23].

Përkushtimi organizativ është gadishmëria e një individit për tju dedikuar përpjekjeve dhe besnikëria ndaj një institucioni [24,25]. Përkushtimi në punë ndodh sepse individit beson se kostoja e largimit nga një institucion është aq e lartë sa është e vështirë që ai të largohet pas konsiderimit të investimit dhe sakrificës të bërë ndaj organizatës [26,27]. Përkushtimi psikologjik quhet edhe përkushtimi normativ [28]. Ky lloj përkushtimi do të thotë se anëtarët e një organizate kanë mendime pozitive dhe aktive ndaj organizatës, dhe ky inklinim përfshin identifikimin me qëllimet, vlerat e organizatës, dedikimin ndaj punës, besnikëri ndaj institucionit [29]. Procesi i formimit të një përkushtimi organizativ fillon me investimin dhe dedikimin që një individ do të zhvillojë një identifikim të fortë me një organizatë pasi individit ka investuar shumë në këtë organizatë në nivel të lartë [30, 31].

Përkushtimi bazë është një fenomen transaksioni midis një individit dhe organizate, dhe ky investim jo i transferueshëm do të rritet me kalimin e kohës; anëtarët nuk duan ta largohen nga organizata për shkak të rrogës, statusit, pozicionit dhe shoqërisë midis kolegëve [32, 33].

Ka disa teori mbi kënaqësinë në punë por teoritë më të zakonshme dhe më të përdorura në shumicën e studimeve të kënaqësisë në punë janë ajo e Masloë, Edëin Locke, Frederick Herzberg dhe Hackman dhe Oldham.

Maslow sugjeron se punonjësit gjithmonë do të kenë tendencën të duan më shumë nga punëdhënësit, kur ata të jenë të kënaqur, ata do të përmbushin më lehtë detyrat e tyre, si cilësinë ndaj klientit, sigurinë e tij etj. Kur puna është e sigurt, punonjësit janë më të kënaqur, dhe në përgjithësi kanë tendencë të mos lëvizin prej punës së tyre [36].

Modeli më i famshëm i teorisë vjen nga Edëin Locke në 1969 ku modeli i tij përcaktohet nga diskrepancia midis atë c'ka dikush do në një punë dhe asaj që ka në atë punë. Për më tepër teoria pohon se sa vlerë i jep dikush një aspekti të punës moderohet në sa i kënaqur ose jo është ky person, kur nuk arrihen pritshmëritë. Kur një person vlerëson një aspekt të vecantë të punës, kënaqësia e tij ka të ngjarë të jetë pozitive (kur arrihen pritshmëritë) dhe negative kur jo [37].

Një teori tjetër në kënaqësinë për punën është teoria dispozicionale. Kjo teori është shumë e përgjithshme dhe sugjeron se njëriçit kanë dispozita të rëndësishme që i bën ata të kenë tendencë kundrejt një niveli të kënaqësisë pavarësisht punës që ata bëjnë. Ky model u bë një shpjegim i rëndësishëm i kënaqësisë në punë dhe evidenton se kënaqësia në punë ka tendencë të jetë e qëndrueshme me kalimin e kohës dhe midis karrierave të ndryshme [38].

Teoria dy faktorëshe e Frederick Herzberg shpjegon kënaqësinë dhe motivimin në vendin e punës. Kjo teori pohon se kënaqësia dhe pakënaqësia shtyhen nga faktorë të ndryshëm, motivimi dhe higjena. Motivimi i një punonjësi në punë vazhdimisht është i lidhur me kënaqësinë e një vartësi të tij në këtë punë. Motivimi mund të shihet si një forcë e brëndshme që e bën individin të marrë qëllime personale dhe organizative dhe ti arrijë ato. Faktorët e motivimit janë ato aspekte të punës që i bëjnë njerëzit të performojnë, u ofrojnë atyre kënaqësi si për shëmbull arritjet në punë, dallimi për punën të mirë dhe mundësitë e promovimit [39].

Hackman dhe Oldham propozuan modelin e karakteristikave i cili përdor idenë e impaktit të karakteristikave të punës në kënaqësinë në punë (variacioni i aftësive, identiteti i detyrës, sinjifikanca e detyrës, autonomia dhe fidbeku), të cilat prekin gjendjet psikologjike dhe më pas rezultatet në punë (kënaqësia, motivimi në punë).

Kënaqësia në punë përshkruan sesa i kënaqur është individi në punë. Sa më të lumtur janë individët me punën e tyre, aq më të kënaqur thonë ata të jenë. Kënaqësia në punë nuk është njësoj si motivimi, por ato janë të lidhura me njëra tjetrën. Mënyra më e zakonshme për të matur kënaqësinë në punë është përdorimi i shkallëve me nivele, ku punonjësit raportojnë reagimet e tyre ndaj punës[40].

2.2 Kënaqësia e punës së infermierëve

Kënaqësia e punës së infermierëve është një aspekt shumë i rëndësishëm dhe një pikë shqetësimi për cdo organizatë shëndetsore. Infermierët kanë vendet më të shumta të punës në këto institucione, dhe zëvendësimi i personelit është i kushtueshëm dhe konsumon shumë kohë. Në punën spitalore shumë kolegë infermierë janë të ekspozuar ndaj niveleve të ndryshme të kënaqësisë në punë, por çfarë i bën infermierët të jenë të kënaqur ose jo me profesionin e tyre, të cilin mund ta kenë zgjedhur edhe vetë? Kur këta infermierë do jenë të pakënaqur, çfarë duhet të bëjnë ata? A është ndryshimi i karrierës një zgjidhje?

Përkushtimi profesional është përkufizuar si përfshirje profesionale e individit, përkushtim, premtim dhe rezolucion ndaj profesionit të tij/saj. Ky përkushtim ka një efekt rritës në qëllimet e individit për të qëndruar apo larguar në institucionin ku ai /ajo punon [34].

Konflikti dhe dyshimi mbi rolin e profesionistit është një faktor madhor në kënaqësinë e punës tek infermierët [35]. Konflikti i roleve ndodh ndërkohë që infermierët përpiqen të përmbushin një sërë kërkesash të cilat vijnë nga pritshmëritë e personave të tjerë në punë për rolin e infermierit. Informacioni jo i përshtatshëm apo i paqartë rreth punës që duhet të bëjë infermieri, limitet e rolit dhe pritshmëritë e personave të tjerë sesi roli infermieror përshtatet me pritshmëritë e tyre prodhon dyshimet për vetë rolin infermieror.

Është shumë e lehtë që nga intuita të lidhet siguria dhe kënaqësia e pacientëve me kënaqësinë e punonjësve në spital. Një punonjes i lumtur fokusohet me shumë në detyrat profesionale, pa u tërhequr vëmendja nga një mjedis negativ dhe con në një performancë më të mirë.

Infermierët që nuk janë të kënaqur në punën e tyre e gjejnë vetën të distancuar nga pacientët dhe punët infermiore, duke rezultuar në ulje të kujdesit shëndetsor. Pakënaqësia në punë shkakton performancë të dobët në punë, produktivitet më të ulët, lëvizje të stafit dhe i kushton financave të organizatës, lidhja midis kënaqësisë në punë dhe performancës është akoma më e lartë për punët komplekse. Plus kësaj, ka shume evidence midis lidhjes së kënaqësisë në punë e punonjësve shëndetsore dhe rezultateve të kujdesit shëndetsor. Stresi dhe sëmundjet kontribuojnë për keq në gjykimin klinik, dëmtojnë pacientët, dëmtim të vetë punonjësve dhe nivel më të lartë mungesash në punë.

Edhe pse lëvizja e infermierëve mund të rivitalizojë një institucion, një lëvizje vullnetare mund të ketë pasoja negative si kosto, humbje e infermierëve me eksperiencë, shkurtim stafi dhe mundësi të rritura për pakënaqësi tek pacientët. Marrëdhënia infermier mjek mund të jetë shumë pozitive, por gjithashtu rezulton në shumë takime stresuese për infermierët. Ky stres luan një rol të rëndësishëm në kënaqësinë në punë, janë bërë shumë studime për sa i përket këtyre marrëdhënieve. Kur kjo marrëdhënie nuk ka respekt dhe besim, rezultati është një mjedis i vështirë pune.

2.2 Statistika të pakënaqësisë në punë

Pakënaqësia në punë zakonisht matet me survejanca të bazuara në pyetësorë, dhe duke parë nivelet e punësimit në profesionin infermieror. Studimet që paraqesin statistika në nivelet e ulëta në kënaqësinë e punës në profesionin infermieror midis inferimerëve kanë filluar që në 1980-tën.

Duke parë të dhënat, shihet një trend që ka spikatur midis studimeve të shumta, është se infermierët që punojnë në spital, sidomos ato në insitucione të kujdestit afatgjatë raportojnë nivelet më të larta të pakënaqësisë në punë. Infermierët që punojnë në praktika klinike të mjekëve apo në punëra farmaceutike, raportojnë nivele më të lartë të kënaqësisë në punë. Edhe pse arsyet e pakënaqësisë infermiore nuk janë si surprizë, kjo është një thirrje për të gjithë ne, sepse ka ardhur koha kur numri i moshave të vjetra e ka kaluar atë të moshave më të reja, pra nevoja për kujdes infermieror po rritet.

Gjetjet nga Anketa e Punësimit të Royal College of Nursing 2017 tregojnë një paraqitje të fuqisë punëtore të infermierisë nën stres të rëndë, i cili në shumë aspekte u përkeqësua në vitet e fundit. Tani, më shumë se kurrë, është e qartë që stafi infermior ndjehet i mbingarkuar, i nënpaguar dhe shpesh duhet të luftojë me mungesë stafi, abuzime dhe moral të ulët në vendin e punës. Kjo u pa duke intervistuar një numër të madh të stafit, dhe me shumë njerëz që përjetojnë probleme shëndetësore dhe financiare. Gjithashtu vëshgimet janë të drejtuara për kujdesin e pacientit; shumica e stafit nuk ndihen në gjendje të ofrojnë nivelin e kujdesit që ata do të dëshironin dhe shumë prej tyre janë në kërkim të largohen nga puna e tyre aktuale ose largohen nga profesioni krejtësisht [41].

Ky vëzhgim rezultoi si më poshtë:

Nëpër pothuajse të gjitha këto të dhëna, stafi infermior që punon në shëndetin mendor, azilet dhe në infermierinë në komunitet raportojnë eksperiencë më të këqija se të tjerët, duke theksuar se stresi i fuqisë punëtore është i lartë sidomos për stafin e në kujdesin primar dhe në zona veçanërisht të mbingarkuara të sistemit të kujdesit shëndetësor dhe social.

1. Stafi infermior ndjehet i mbingarkuar, i papaguar dhe i paafte për të siguruar nivelin e kujdesit që ata dëshirojnë, duke e ngadalësuar pakënaqësinë e përgjithshme me rolin e tyre:

- Shumica (63%) e personelit të infermierisë mendojnë se janë shumë të zënë për të siguruar nivelin e kujdesit që ata do të dëshironin dhe përqindja e njëjtë mendon se ata janë nën presion shumë të madh në punë.

- 71% punojnë orë shtesë së paku një herë në javë, por vetëm gjysma paguhen për këto orë.

- Më shumë se gjysma (61%) tani mendojnë se niveli i tyre i pagave është i papërshtatshëm, në mënyrë të konsiderueshme nga vitet e fundit, me rezultate veçanërisht të ulëta të kënaqshmërisë

- Pakënaqësia me nivelin e pagave është e lidhur ngushtë me arsyen se paga nuk përputhet me nivelin e përgjegjësisë, detyrave apo intensitetit të punës.

2. Shtimi i presioneve të punës janë të lidhura ngushtë me kujdesin afatshkurtër të personelit dhe komprometuar të pacientëve:

- 79% mendojnë se nivelet e stafit në vendin e tyre të punës janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e pacientit.

- Tre të katërtat (77%) mendojnë se kujdesi për pacientin kompromentohet disa herë në muaj ose më shumë për shkak të stafit të shkurtër.

3. I gjithë stafi infermieror ndjehet më keq financiarisht, por brengat financiare janë më të theksuara në mesin e infermierëve me pagë më të ulët.

- Shumica e stafit infermieror (75%) ndihen financiarisht më keq se pesë vjet më parë.

- Pothuajse tre të katërtat (74%) të infermierëve në grupet 1-4 raportojnë problem financiarë. Gjatë vitit të kaluar, 33 % e stafit në grupet 1-4 raportojnë se po luftojnë për të paguar faturat e shërbimeve, 22 % e raportit mungojnë ose nuk janë duke paguar faturat ose pagesa për qiranë dhe 64 % e raportit kursejnë në ushqime apo udhëtime.

4. Nivelet e larta të sëmundjeve, keqtrajtimit, ngacmimeve dhe ngacmimeve karakterizojnë shumë vende pune.

- Vetëm gjysma (49%) e stafit infermieror thonë se ata kanë shkuar të punojnë pa u sëmurë të paktën dy herë gjatë vitit të kaluar. Çështjet e stresit dhe shëndetit mendor përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të problemeve shëndetësore.

- Rreth një e katërta e infermierëve (27%) kanë përjetuar abuzim fizik nga pacientët, përdoruesit e shërbimit ose të afërmit gjatë 12 muajve të fundit dhe 68% kanë përjetuar abuzime verbale nga të njëjtat grupe.

- Një në tre personel infermieror (31%) thotë se ata kanë përjetuar ngacmime ose ngacmime nga kolegët gjatë 12 muajve të fundit, sidomos infermierët me aftësi të kufizuara më shumë gjasa për të raportuar ngacmimet sesa të tjerët.

5. Morali i varfër dhe mundësitë zhvillimore nënkuptojnë se një numër në rritje i stafit po e vënë në dyshim karrierën e tyre në infermierinë.

- Personeli infermieror ka më pak gjasa të rekomandojë infermierinë si një karrierë sesa në çdo moment në 10 vitet e fundit. Vetëm 41 % thonë se do të rekomandonin infermierinë si një karrierë.

- Mbi gjysma (54%) e stafit infermierik mendojnë se nuk kanë mundësi të përparojnë në punën e tyre aktuale. Tek infermierët e regjistruar, ata që u kualifikuan për herë të parë jashtë Mbretërisë së Bashkuar pothuajse dy herë më shumë se sa infermierët e kualifikuar në Mbretërinë e Bashkuar për të shprehur pasiguri rreth mundësive të tyre për përparim, duke sugjeruar se pasiguria e vazhdueshme rreth statusit të shtetasve të BE-së, pas Brexit ndikim negativ.

- Më shumë se një e treta (37%) e stafit infermieror janë duke kërkuar një punë të re. [41]

Në vitin 2018 nga disa studiues u bë një rishikim literaturë mbi kënaqësinë në punë të infermierëve gjatë viteve 2000-2016. Ky artikull përdori databazat CINAHL, MEDLINE, Scopus dhe Eeb of Science. Në studim u përfshinë të gjitha studimet që kishin në konsideratë kënaqësinë e infermierëve në punë, të të gjitha specialiteteve. Pas përjashtimeve të disa studimeve sipas kriterëve të përzgjedhjes, në përfundim u përzgjedhën 20 artikuj mbi këtë temë. Nga këto studime 15 (75%) studime ishin kuantitative, 4 (20%) projekte kualitative dhe (5%) të përziera. Shumica e studimeve ishin kryer në Kanada ($n = 8$, 40%), kurse të tjerat në Mbretërinë e Bashkuar ($n = 4$, 20%), SHBA ($n = 5$, 25%), 1 nga Arabia Saudite, Afrika e Jugut dhe Brazili.

Të gjitha studimet përfshinë një mostër infermierësh që varionte nga 31 në 1044 pjesëmarrës. Ata ishin infermierë në komunitet, në spitale, azile, në shkollë etj.

11 studime (55%) kishte studim vetëm për kënaqësi në punë, 3 studionin ndryshim karriere, 6 të tjera kombinonin kënaqësinë me karrierën. Në përgjithësi qëllimet e studimeve ishin vlerësimi i kënaqësisë në punë, faktorët që ndikonin në këtë kënaqësi, kushtet e punës, përkushtimin organizativ, mendimet për profesionin, dhe faktorët që i conin në ndërrim profesioni, mbikqyrja, trajnimet, cilësia e shërbimit.

Variacionet në matjen e kënaqësisë në punë në këto studime dhe ndryshimet e bënin të vështirë krahasimin. Shumica e mjeteve që matnin kënaqësinë në punë përdorën shkallën Likert (jam dakort, nuk jam dakort).

Në disa studime vetëm gjysma e pjesëmarrësve ishin të kënaqur nga puna e tyre, ndërsa të tjerët jo. Vetëm në një numër të moderuar studimesh infermierët raportonin nivele deri diku të larta për kënaqësinë në punë.

Për sa i përket faktorëve që ndikonin në kënaqësinë në punë kishte lidhje sinjifikante midis faktorëve demografike me kënaqësinë. Në disa nga studimet u pa që moshë më e madhe rriste kënaqësinë në punë, arsimi më i lartë gjithashtu raportohej se kishte kënaqësi më të lartë.

Eksperienca në punë u pa se infermierët me mbi 10 vite punë kishin në mënyrë sinjifikante më të lartë kënaqësinë në punë. Faktorë të tjera u pa se ishin mbështetja organizative, kënaqësia e pacientëve, vendimarrja.

Në shumicën e studimeve kishte një dakortësi midis faktorëve që ndikonin pozitivisht në kënaqësinë në punë. Këtu futeshin roli profesion, respekti nga menaxherët, marrëdhëniet në punë me kolegët dhe fleksibiliteti në rolin e infermierit dhe pavarësia.

Për sa i përket faktorëve që ndikonin negativisht në kënaqësinë në punë shumica e studimeve arritën në konkluzione të ngjashme ku puna në spital, pagesa, raporti infermier pacient, mungesa e qartësisë së rolit në punë, dhe komunikim i keq organizativ.

Në aspektin e qëndrimit në të njëjtën karrierë u pa se pothuaj gjysma e infermierëve me moshë mbi 50 vjeç kishin për qëllim të largoheshin nga profesioni brenda dy vjetësh [42].

Mungesa e produktivitetit dhe pamundësia për të ofruar kujdes infermieror më të mirë janë identifikuar të dy si faktorë kryesorë për pakënaqësinë në punë të infermiereve. Një studim nga Linda H. Aiken, Ph.D., R.N., I publikuar në "Journal of the American Medical Association" in 2012 gjithashtu demostroi se janë gjithashtu edhe relacionet midis raportit të lartë infermier-pacient, vetë infermierët dhe rezultatet e tyre, pafuqishmëria në punë, janë faktorë të pakënaqësisë [43].

2.3 Mendimet infermiere mbështetja organizative dhe cilësia e kujdesit

Duke parë shumë studime në të cilat është vënë në dukje se infermierët nuk dalin të jenë shumë të kënaqur nga puna e tyre në ambiente spitalore, disa studiues së bashku vendosën që ta krahasonin se sa të kënaqura ishin infermierët në Evropë (Angli, Skoci, Gjermani) SHBA dhe Kanada. [44].

Në këtë studim të gjerë u raportuan shume probleme si në organizimin e punës infermiere ashtu dhe dizenjon e punës, duke raportuar se stresi, tejlodhja dhe pakënaqësia në punë nuk ishin karakteristika unike vetëm të infermierëve amerikanë. Në cdo rast, më shumë gjysma e infermierëve raportuan se nuk kishte mjaftueshëm infermierë për të ofruar kujdes cilësor, kjo nga ana e vet ka ndikuar në pakënaqësinë e tyre në punë. Me përjashtim të Gjermanisë, të paktën 1 nga 3 infermiere ishin të tejlodhur. Tek infermierët nën moshën 30 vjece, të paktën 25% planifikonin ta linin punën brenda vitit; në Angli ishin më shumë se gjysma. Infermierët ishin dakort se puna me mjekët ishte e mirë, por kryeinfermierët raportuan se nuk kishte mbështetje mjaftueshëm për të kryer punën, dhe më pak se gjysma mendonin se administrata i dëgjonte shqetësimet dhe iu përgjigjen atyre. Të paktën 1 në 3 infermiere kryenin punë rutinë që nuk ishin në profesionin infermieror si marrja dhe ofrimi i tabakave të ushqimit (punë e ndihmës infermierëve), transporti i pacientëve (kur ka persona të tjerë që merren me këtë punë). Në të njëjtën kohë ata po humbnin kohë të kryenin punë infermiere si higjenë orale dhe të lëkurës, edukim pacientësh për dalje nga spitali dhe kujdes në shtëpi, bisedim me pacientët dhe ofrim i mbështetjes psikologjike. Ky është një nga studimet e para që përshkruan sesi infermierët ndihen për veten, vendit të punës dhe punës së tyre.

2.4 Studime mbi kënaqësinë në punë të infermierëve

2.4.1 Lidershipi, vazhdimi i karrierës dhe edukimit, mungesa e stafit

Në çdo anketë infermierët janë pyetur për pikëpamjet e tyre për profesionin e tyre të zgjedhur dhe punën aktuale. Çdo vit, një përqindje shumë e madhe e infermiereve thonë se janë të kënaqur me zgjedhjen e tyre të karrierës, ndërkohë që një përqindje shumë e vogël - zakonisht në shifrat e vetme - nuk pajtohen. Megjithatë, një përqindje dukshëm më e vogël, edhe pse ende shumicë, thonë se janë të kënaqur me punët e tyre të tanishme. Më shumë se gjysma thonë se shqetësohen se punët e tyre po ndikojnë në shëndetin e tyre, edhe pse kjo ndoshta nuk është për t'u habitur për punën emocionale dhe fizike të infermierisë. Shumë thonë se shpesh ndihen sikur po ikin, dhe shpresojnë se nuk do të punojnë në punën e tyre të tanishme brenda një viti. Por pastaj, dy të tretat thonë se do t'i inkurajonin të tjerët të bëhen infermierë. Është e qartë se krenaria e infermierisë shkon shumë e thellë. Megjithëse i mbushur me sfida, infermiera është shtylla e kujdesit cilësor të pacientëve, dhe shumica e infermiereve kurrë nuk duan të bëjnë ndonjë gjë tjetër [45].

- 82% e infermiereve bien dakord ose pajtohen fuqishëm që nevojiten më shumë liderë të infermiereve; vetëm 5% nuk pajtohen.
- Gati gjysma e infermiereve ose nuk ishin dakord ose ishin ambivalentë kur u pyetën nëse mund t'u besonin udhëheqësve të tyre.
- Gjysma e infermiereve ose nuk ishin dakord ose ishin ambivalentë kur u pyetën nëse udhëheqësit e tyre mbështetën zhvillimin e karrierës së tyre.
- 61% e infermiereve thanë se nuk do të konsideronte pozicionin lideri megjithëse 17% thanë se tashmë ishin në një pozitë udhëheqëse. Infermieret e rinj (19-36) kishin më shumë gjasa - 36% - të interesoheshin për të hyrë në një pozitë udhëheqëse.
- 27% e infermiereve në vitin 2017 që planifikojnë të dalin në pension thonë se do ta bëjnë këtë në më pak se një vit, krahasuar me 16% në vitin 2015.
- 36% e infermiereve në vitin 2017 thanë se planifikojnë të dalin në pension në një vit ose më pak.
- 46% e infermiereve në vitin 2017 që planifikojnë të dalin në pension thonë se do ta bëjnë atë në katër vjet ose më shumë, krahasuar me 62% në 2015.
- 73% e infermiereve të Baby Boomer që planifikojnë të dalin në pension thonë se do ta bëjnë këtë në tre vjet ose më pak.
- 48% e infermiereve në vitin 2017 thanë se mungesat e infermierisë janë më të këqija se pesë vjet më parë, krahasuar me 37% në 2015.
- 22% e infermiereve në vitin 2017 thanë se mungesa e infermierisë nuk është aq e keqe sa pesë vjet më parë, krahasuar me 34% në vitin 2015.
- 83% e infermiereve thonë se janë të kënaqur me zgjedhjen e tyre të infermierisë si karrierë; vetëm 9% nuk pajtohen.

- 73% e infermierëve thonë se janë të kënaqur me cilësinë e kujdesit që ata japin.
- 66% e infermierëve thonë se do të inkurajojnë të tjerët të bëhen infermierë .
- 60% e infermierëve thonë se janë të kënaqur me punët e tyre aktuale • 55% infermieret shqetësohen se punët e tyre po ndikojnë në shëndetin e tyre.
- 44% e infermiereve thonë se zakonisht nuk kanë kohën që duhet të shpenzojnë me pacientët e tyre.
- 38% e infermierëve thonë se shpesh ndihen si të lënë punën.
- 35% e infermierëve thonë se shpresojnë ata nuk do të punojnë në punën e tyre aktuale në një vit [45].

2.4.2 Produktiviteti

Në një artikull të shkruar nga D. K. McNeese-Smith, u investiguan problemet e produktivitetit dhe faktorët që rritnin ose ulnin produktivitetin. Këtu u përdorën intervista të semi-strukturuara për të mbledhur të dhëna që influencojnë produktivitetin. U intervistuan 30 infermierë. Sasia e punës së kryer ishte një faktor kyç në ndjenjën e të ndjerit produktiv në punë, ku temat e të intervistuarve ndiheshin sikur i kishin mbaruar të gjitha punët, ishin eficientë, qëndronin vonë, bënë punë më tepër sesa duhej, pa shpërblim monetar [46]

Cilësia e punës u bazua në disa apekte të punës infermiere. Respondentët ndjenin se edukimi dhe kujdesja për pacientët shkakton kënaqësi në punë dhe produktivitet në punë. Shumë prej tyre mendonin se sugjerimet e ofruara përmirësojnë procesin e kujdesit infermieror.

2.4.3 Tejlodhja

Burnout është një eksperiencë fizike emocionale dhe mendore shumë e tejlodhshme e shkaktuar nga përfshirja afatgjatë në situata që janë shumë kërkuese emocionalisht [47].

Një përkufizim tjetër është indeksi i shkëputjes nga ajo që janë njerëzit dhe asaj cka ata duhet të bëjnë. Ai paraqet një erosion në vlera, dinjitet, shpirt, dhe dëshirë, një shkatërrim të shpirtit të njeriut [48].

Ai mund të manifestohet si depresionalizim, produktivitet i ulët, dhe ndjeja të një arritje të ulët. Ky fenomen duket se ka dy element të dukshëm të konfliktit.

I pari është puna e një rutine të rëndë, monotone dhe të mërzitshme dhe e dyta është tejlodhja e vërtetë nga vite përpjekjeje përmes kërkesës dhe ndryshimit. Burnout ka tre komponentë; tejlodhjen fizike; emocionale, dhe arritjet personale të ulëta.

Kjo con në një pamundësi për të marrë pjesë në shumë aspekte të punës por sidomos në ato aspekte që kërkojnë ndërveprim. Të folurit bëhet pa ton, gjestet e fytyrës dhe të trupit zhduken

dhe personi bëhet më pak përgjegjës për situatën ndaj kërkesave për një ndërveprim profesional [48].

2.4.4 Fuqizimi struktural

Në një artikull të shkruar nga H. K. Spence Laschinger dhe D. Sullivan Havens, autorët kanë diskutuar testimin e teorisë së Kanterit për fuqizimin organizativ [49]. Bazuar në punën e Kanterit, fuqizimi është përkufizuar si një gjendje e cila rrit aftësinë e një njeriu dhe motivimin për të zhvilluar dhe patur përdorim më konstruktiv të talentit dhe eksperiencës së tyre. Autorët kishin për qëllim të studionin efektet e fuqizimit organizativ në efektivitetin e punës dhe cilësinë e kujdesit mbi pacientët[50].

Ata përdorën 525 infermierë në 49 reparte në spitalet e Ontarios dhe pyetësorë për të investiguar dhe variablat e studimit ishin; mundësia, informacioni, mbështetja dhe fuqia formale ajo joformale, tensioni në punë, efektiviteti i punës dhe arritja e qëllimeve në punë.

Si rezultat u pa se fuqia organizative dhe socializimi kishin efekte sinjifikante në efektivitetin e punës në reparte dhe kjo përkthehet në nivele më të larta kujdesit të ofruar për pacientët dhe të kënaqësisë në punë ($\beta = .05$ and $\beta = .29$, $P < .05$).

2.6 Studime mbi faktorët demografikë që ndikojnë në kënaqësinë në punë

Ka disa faktorë demografike që luajnë rol në nivlet e kënaqësisë në punë. Janë kryer shumë studime në mbarë botën për të vlerësuar nivelin dhe sesi ndikojnë këta faktorë, negativisht ose pozitivisht në të.

2.6.1 Statusi martesor, eksperiencia në punë

Në një studim të kryer në Kuvajt për të vlerësuar kënaqësinë e punës infermiere u gjetën marrëdhënie të konsiderueshme pozitiv të kënaqësisë në punë me statusin martesor. Megjithatë, një nivel më i lartë i kualifikimit arsimor tregoi një marrëdhënie të rëndësishme me kënaqësinë në punë [51] i cili është mbështetur edhe nga Larrabee et al. [52]. Por studime të tjerë infermiere tregojnë se infermieret e rinj me më pak eksperiencë në punë, tituj të ulët profesional, dhe pozicionet më të ulëta të punës kanë përjetuar nivele të ulëta të tejlohdjes emocionale e cila është e lidhur pozitivisht për kënaqësinë e punës dhe negativisht për nivelin e lëvizjes në profesion [59]. Përsëri kjo ide bie ndesh me Cameron et al. i cili tha se infermierët me më shumë vite përvojë patën kënaqësinë më të lartë të punës së tyre, tejlohdjen më të ulët, dhe kishin më pak gjasa për të lënë profesionin [53].

Në Kanada lëvizja e infermierëve në raport me vitet e shërbimit ishte se 30% e infermiereve të reja e lanë punën e tyre në vitin e parë dhe 57% dhanë dorëheqjen në vitin e tyre të dytë [62]. Për infermieret amerikane, përvoja e përgjithshme infermiere ishte e lidhur në mënyrë të konsiderueshme për qëllimin për infermieret me përvojë më pak se 1 vit dhe në mes 10 dhe 11,5 vjet përvojë kishin më pak gjasa për të treguar synimin për të lënë punën sesa ato me 1-1,5 vjet përvojë (vlerat <0,05) [54].

2.6.2 Moshë dhe gjinia

Moshë dhe punonjësit është konsideruar si një faktor tjetër që ndikon të kënaqësinë e punës dhe të qëndrimit në profesion. Në një studim të bërë në Kinë, për infermierët 20-30-vjeçarë, kënaqësia në punë dhe stresi në punë ishin parashikues të rëndësishme të lëvizjes së parashikuar. Për infermieret 31-40 vjeçarë, kënaqësinë në punë ishte parashikuese e lëvizjes së parashikuar. Për infermieret 41-50 vjeçarë, kënaqësia e punës dhe marrëdhënia në grup ishte parashikuese e lëvizjes së parashikuar. Për infermieret që janë 51 vjec ose më të vjetër, nuk ka pasur parashikues të rëndësishme të lëvizjes [55].

Infermiera është një nga profesionet e shumta në të cilat një gjini e caktuar përbën shumicën e punëtorëve, ndërsa diferenca gjinore është raportuar si faktor për kënaqësinë e punës dhe të lëvizjes së infermiereve. Në studimin e kryer në Maryland për të hetuar arsyen e largimit nga puna midis grave dhe burrave ata gjetën 69,7% e burrave cituan pagat më të mira si një arsye për të lënë infermierinë në kontrast me vetëm 32,6% e femrave dhe 63,6% e meshkujve mendonin se pozicioni i tyre aktual më të dobishëm profesionalisht krahasuar me vetëm 46,1% e grave. Nuk është vetëm arsyeja që ata ndryshojnë, por edhe normat e tyre të largimit raportuar në sondazhet e infermiereve kanë treguar dallime të rëndësishme në normat e largimit të infermierisë midis burrave dhe grave; 7,5% e burrave infermiereve e lanë profesionin infermior brenda 4 viteve të diplomimit nga shkolla e infermierisë, krahasuar me 4% të grave [56].

2.6.3 Promovimi

Promovimi është një nga faktorët motivues që mund të parandalojë në mënyrë efektive pakënaqësinë e punonjësve por në një studim të kryer në 500 (87,2% Shkalla e përgjigjeve) infermierë në Kuvajt, infermierët janë të pakënaqur me mundësitë profesionale dhe përfitimeve jokarakteristik ndërsa ata ishin të kënaqur me lavdërimin dhe mirënjohjen, caktimin e detyrës, dhe kontrollet dhe përgjegjësinë në punë [51].

Një tjetër studim i bërë në infermieret palestineze tregon se mungesa e karrierës dhe mundësitë e avancimit si dhe politikat jo mbështetëse spitalore kanë kontribuar në pakënaqësinë ndaj vendit të punës [57].

Saari dhe Judge tregojnë në rezultat e tyre të analizës prej shumëgjeneratash të forcës së punës infermiere, se siguri dhe mbështetja e arsimit apo mundësitë e karrierës në zhvillimi mund të jetë një tjetër strategji për të rritur kënaqësinë e përgjithshme të punës për infermieret [58].

2.7 Infermiera dhe profesioni infermieror në Shqipëri

Me reformat e vazhdueshme në zhvillimin ekonomik dhe shëndetsor, Shqipëria ka bërë ndryshime madhore për sa i përket kujdesit shëndetsor. Qeveria dhe instancat drejtuese të Ministrisë së Shëndetsisë kanë liberalizuar disa ndryshime majore të filluara nga urdhri i Infermierit Shqiptar dhe i bazuar në protokollin e koheve të fundit në praktikën infermiere. Në Shqipëri janë hapur shumë spitale private dhe klinika, të cilat janë të lira nga kontrolli i qeverisë dhe shtetit në menaxhimin e punës dhe vecanërisht në marrjen në punë të stafit.

Reformat në modelin e kujdesit infermieror kanë patur një impakt në ofrimin e kujdesit shëndetsor. Kujdesi infermieror me qëndër pacientin ka zëvendësuar gradualisht modelin me qëndër sëmundjen. Këto ndryshime kanë koiciduar me një rritje të kuptimit të statusit profesional të infermierëve duke qënë se ka disa vite që në Shqipëri funksionon UISH dhe profesioni i infermierit është profesion i rregulluar me ligj, “provim lishence kërkohet para se të punësohet një infermier”.

Edhe pse studiuesit kanë treguar disa nivele të kënaqësisë në punë për infermierët, predikuesit e kënaqësisë kanë tendencën të jenë shumë të ngjashëm, dhe përfshijnë kushtet e punës, marrëdhëniet me kolegët dhe drejtuesit, pagën, promovimin në punë, sigurinë për ta patur punën, përgjegjësinë dhe turnin. Në Shqipëri nuk jam në dijeni nëse ka studime që kanë vlerësuar efektin e liderimit, karakteristikave të personalitetit, dhe kompetencat menaxheriale të drejtuesve në punë. Gjithashtu klima organizative dhe kultura organizative në infermieri nuk dihet të jenë studiuar apo botuar në revista shëndetsore.

Aktualisht në Shqipëri egzistojnë dy lloj diplomash infermiere, ajo Bachelor me 3 vite studimi, dhe ajo master (professional ose shkencor) me 4-5 vite studimi, por ka dhe disa infermierë të cilët kanë shkollën e mesme mjekësore, por shumë prej tyre janë përpjekur të mbarojnë një shkollë të lartë infermiere në disa shkolla të larta infermiere si në Vlorë, Tiranë, Korçë. Secila prej këtyre degëve, pranon deri diku tek 100 studentë në vit, duke diplomuar pothuaj të njëjtin numër. Shumica e tyre gjejnë punë në spitalet rajonale, disa gjejnë punë jashtë shtetit, sidomos kohët e fundit ka filluar lëvizja në masë e infermierëve në Gjermani.

Ka disa qendra private spitalore, sidomos në Tiranë dhe disa prej këtyre infermierëve të rinj kanë mundësi të fillojnë punë në këto institucione.

Përkushtimi organizativ dhe kënaqësia në punë është studiuar nga një grup studiuesish këtu në Shqipëri në vitin 2016. Ka një mungesë studimesh për sa i përket përkushtimit dhe kënaqësisë në punë në spitalet Shqipëtare thekson ky studim. Qëllimi i këtij studimi ishte përkushtimi i përkushtimit organizativ në punë, dhe kënaqësisë në punë për sa i përket dimensioneve të

ndryshme të attributeve në punë. Ky studim kros seksional përdori pyetësin në Shqipëri të kënaqësisë në punë dhe pjesën demografike dhe u krye në disa spitale publike. Studimi përfshiu 400 pyetësorë nga një periudhë kohore Tetor – Dhjetor 2011, duke përdorur vetëm 246 pyetësorë të përshtatshëm për përpunim statistikor. U krye një analizë regresioni dhe testi t për të konfirmuar hipotezën. Në rezultate u pa se natyra e punës, rroga dhe cilësia e mbikqyrjes ishin positive për kënaqësinë në punë, kurse mundësitë e promovimit dhe kolegët e punës ishin faktorë negativë [59].

Në vitin 2016 në spitalin rajonal Vlorë u krye një studim mbi kënaqësinë e infermierëve dhe faktorët që ndikojnë në të duke përdorur një pyetësor nga Mueller and McCloskey Satisfaction Scale (MMSS). Nga rezultatet u vu re se ndjenja e infermierëve ndaj profesionit ishte pothuajse neutrale. Faktorët e jashtëm më kryesorë që kanë prekur intensitetin e kënaqësisë në punë janë paga mujore, ndërsa faktori i brendshëm ishte promovimi në karrierë. Infermierët më të pakënaqur ishin ata me më pak se dy vjet punë. Asnjë prej tyre nuk ishte i kënaqur në punë. Ata që ishin të kënaqur ishin infermierë me mbi 10 vjet punë. Një nga rezultatet ishte se sa më të rinj infermierët aq më të prekur ishin nga faktorët për kënaqësinë në punë [60].

Një studim tjetër mbi kënaqësinë në punë u krye nga V. Prifti, S. Nikaj; i publikuar në konferencën studentore të vitit 2019 por studimi ishte kryer në vitin 2013.

Qëllimi i kësaj teme ishte vlerësimi i pikëpamjeve dhe eksperiencave të infermierëve për sa i përket komponentëve të ndryshëm të kënaqësisë në punën infermirore në spitalin rajonal të Vlorës.

Në këtë studim morën pjesë 109 infermierë nga spitali i Vlorës dhe plotësuan një pyetësor me disa rubrika (60 pyetje) për të parë nëse ata ishin të kënaqur me punën e tyre dhe nëse kishte faktorë që ndikonin në këtë kënaqësi. U konsideruan sinjifikante vlerat e $p \leq 0,05$. Analiza e të dhënave u realizua përmes paketës statistikore SPSS version 2.0.

Rezultatet: 43% e infermierëve nuk ishin të kënaqur me punën e tyre, 29% e të intervistuarve deklarojnë se duan të largohen nga institucioni ku punojnë. Personeli që deklaroi të ketë bërë si zgjedhje primare profesionin e infermierit është më i motivuar për të qëndruar në institucionin shëndetësor ku punon. Ka një lidhje tepër sinjifikante midis dy variablave. (Testi χ^2 . Pearson Koef. 18.7, df1, $p < 0.01$.) personat me experiencë punë më të lartë nuk duan të largohen nga institucioni. 30% e infermierëve nuk janë të kënaqur me përkushtimin organizativ. 28% nuk janë të angazhuar në profesion. 45% kanë konfliktualitet të ulët. Gjendja civile rrit konfliktualitetin.

Si konkluzion ky studim pohoi se në përgjithësi infermierët në spitalin rajonal të Vlorës nuk janë të kënaqur. Gjinia dhe mosha janë të lidhur më kënaqësinë në punë, arsimi dhe mosha janë të lidhur me përkushtimin organizativ. Gjithashtu ka konfliktualitet në rolin infermirore [61].

Por sa të kënaqur janë infermierët si të rinj ashtu dhe me experiencë disa vjeçare në spital? Si ka ecur përmirësimi i nivelit të kënaqësisë në punë në spitalin rajonal të Vlorës?

Këtë do ta konstatojmë në paraqitjen e rezultateve të mëposhtme.

Kapitulli III. METODOLOGJIA

3.1 Qëllimi i studimit:

Vlerësimi i kënaqësisë në punë të infermierëve të reparteve të pediatri në spitalet Fier dhe Vlorë në mënyrë që të gjendjen faktorët që ndikojnë në të.

3.2 Objektivat

1. Evidentimi i kënaqësisë së personelit infermieror të repartit të pediatriisë të Spitalit Rajonal Vlorë dhe Fier.
2. Evidentimi i përkushtimit organizativ të infermierëve të repartit të pediatriisë ndaj spitalit rajonal Vlorë dhe Fier si institucioni bazë i punës së tyre.
3. Evidentimi i përkatësisë në profesion të infermierëve të repartit të pediatriisë të spitalit rajonal të Vlorës dhe të Fierit.
4. Evidentimi i konfliktit të roleve të pritshëm të infermierit nga pacientët dhe kolegët gjatë punës të repartit të pediatriisë në spitalin rajonal të Vlorës dhe të Fierit.

3.3 Hipoteza

- Infermierët e spitalit rajonal të Vlorës dhe të Fierit në repartet pediatrike janë të kënaqur nga puna e tyre.
- Infermierët të cilët kanë dëshirë të largohen nga spitali përjetojnë një nivel më të ulët të kënaqësisë dhe përkushtimit në punë.
- Ka disa faktorë rreziku që ndikojnë në nivelet e kënaqësisë dhe përkushtimit të infermierëve në punë.
- Infermierët të cilët përjetojnë një nivel të lartë të kënaqësisë në punë tregohen më të përkushtuar nga ana organizative.

3.4 Tipi i studimit, popullata dhe zgjedhja e kampionit në studim.

- Ndër - seksional (transversal).
- Periudha e studimit Shkurt -Maj 2019.
- Infermierët e reparteve të pediatriisë së spitaleve Vlorë dhe Fier.
- U përzgjedhën në mënyrë të rastësishme personel infermieror (N=50), nëpër repartet e pediatriisë, të cilët pranuan të jepnin mendimin e tyre lidhur me kënaqësinë e tyre me punën që kryenin.

3.5 Mbledhja e të dhënave

U realizua nëpërmjet një pyetësoi i cili u bë i qartë paraprakisht nga ana e intervistuesit. U ruajt anonimiteti i personit, privatësia si dhe komforti në plotësimin e tij.

3.6 Hartimi i Pyetësoi.

Aplikimi i pyetësoi, hedhja dhe analiza e të dhënave u bë nga studiuesi (unë). Para plotësimit të pyetësoi u sqaruan paraprakisht të intervistuarit lidhur me paqartësitë e mundshme.

U mor leje nga kryeinfermieret e reparteve dhe drejtorja e spitalit.

Pyetëtori (instrumenti i përdorur) është i bazuar gati plotësisht mbi literaturën bashkëkohore, që përdoret gjerësisht në insitucionet shëndtësore për të marrë feedback lidhur me kënaqësinë në punë të personelit infermieror, me qëllim vlerësimin e mangësive, për të motivuar me shumë personelin infermieror në realizimin sa më cilësi të punës në kujdesin infermieror.

(Job satisfaction and its related factors: Hong Lu; Alison E. while; K. Louise. International Journal of Nursing Studies 44 (2007) 574–588)

3.7 Pyetëtori përmbante komponentët e mëposhtëm:

- Të dhënat socio - demografike: gjinia, vendbanimi, gjendja civile, arsimimi, përvoja në punë, institucioni; të dhëna lidhur me cilësitë e personelit infermieror, opinionet e tyre rreth punës, organizimit, bashkëpunimit, menaxhimit etj. (7 pyetje)
- Pjesa e dytë kënaqësia në punë: 13 pyetje, me përgjigje të mbyllura sipas shkallës së vlerësimit Likert (1-5 shumë i pakënaqur – shumë i kënaqur)
- Pjesa e tretë për përkushtimin organizativ 12 pyetje të organizuara sipas shkallës së vlerësimit të shkallës Likert (1-6 nuk ajm fare dakort – jam shumë dakort)
- Pjesa e katërt për përkushtimin në porfesion me 9 pyetje me përgjigje të mbyllura sipas shkallës së vlerësimit Likert (1-5 (1- kurrë-5 shumë shpesh)
- Pjesa e pestë për konfiktin e roleve me 12 pyetje me përgjigje të mbyllura sipas shkallës së vlerësimit Likert (1- kurrë-5 shumë shpesh)

3.8 Përkufizimi i ndryshorëve (variableve) të përfshirë në studim

<i>Ndryshorët (variablet) e pavarur</i>		
Institucioni	Deklarim nga infermieri	Fier Vlorë
Gjendja civile	Vetëdeklarim gjendjes së tyre	I martuar, beqar, I diorcuar
Vendbanimi	Vetëdeklarim	Fshat –qytet
Përvoja në punë:	Vetëdeklarim: Sa vite kanë infermierët në këtë institucion	<ol style="list-style-type: none"> 1. Më pak se 5 vite 2. 6-14 vjet 3. 15-24 vjet 4. Mbi 25 vjet
Arsimi	Vetëdeklarim: Sa vite shkollë kanë mbaruar këta infemrierë	Bachelor Master professional Master shkencor

<i>Ndryshorët (variablet) e varur</i>		
Kënaqësia në punë	Pyetësor Kënaqësia në punë është një sjellje pozitive ose negative që punonjësi ka ndaj punës së vet ose disa aspekteve specifike të punës, dhe është një gjendje e brendshme mendore e individit, matur me pyetesor.	Shkalla Likert (1-5 shumë i pakënaqur – shumë i kënaqur)
Përkushtimi organizativ	Pyetësor Përkushtimi organizativ është gadishmëria e një individi për t'iu dedikuar përpjekjeve dhe besnikëria ndaj një institucioni.	Shkalla Likert (1-6 nuk jam fare dakort – shumë dakort)
Përkushtimi profesional	Pyetësor Është përkufizuar si përfshirje profesionale e individit, përkushtim, premtim dhe rezolucion ndaj profesionit të tij/saj.	Shkalla Likert (1-5 kurrë – shumë shpesh)
Konflikti në realizimin e detyrave	Pyetësor Praktika profesionale është perceptimi i integritimit në organizatë, mjedisin me kolegët. Konfliktet e lindura për shkak të punës.	Shkalla Likert (1-5 kurrë – shumë shpesh)

3.9 Kodimi dhe Analiza e të dhënave

- Kodimi: çdo ndryshor u kodua sipas qëllimit dhe mundësive që ofron paketa statistikore SPSS version 22 për të bërë të mundur analizimin e të dhënave.
- Kodimi i realizuar pas plotësimit të pyetësorëve dhe në përputhje me strukturën e pyetësorit për të lehtësuar sa më shumë të jetë e mundur procesin e hedhjes së të dhënave.
- Hedhja e të dhënave u realizua nga studiuesi dhe u verifikuan nga udhëheqësi i studimit (tezës) .
- Editimi i të dhënave: Mospërputhjet e vërejtura u shoqëruan me rikontrollin respektiv të pyetësorit ose të mënyrës së kodimit të të dhënave, duke verifikuar rast pas rasti.
- Të dhënat e vazhdueshme u paraqitën në vlerë mesatare.
- Të dhënat diskrete u paraqitën në vlerë absolute dhe në përqindje.

Për paraqitjen e të dhënave u përdorën :

